



## **Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijët në Qytetin e Nju-Jorkut (NYC Office of Child Support Services) Programi i suksesit të prindërve (Parent Success Program): Trajtimi me medikamente Pyetje të shpeshta (FAQ)**

Për prindërit të cilët kanë borxhe të përhershme të caktuara për mbështetjen financiare për fëmijën të detyruara kundrejt Departamentit të Shërbimeve Sociale të Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Department of Social Services, NYC DSS), Programi i Suksesit të Prindërve i Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijët e Qytetit të Nju-Jorkut (OCSS) mund t'ju ndihmojë ta reduktoni atë borxh deri në \$7,500, duke përfunduar trajtimin e miratuar të medikamenteve ose programin e shërbimeve të punësimit.

Pse po e ofrojmë këtë program? OCSS-ja e kupton që shumat e mëdha të borxhit mund ta bëjnë më të vështirë për prindërit të përmirësojnë jetën e tyre ose të mbështesin financiarisht fëmijët e tyre.

Për informacion rreth mënyrës se si të reduktoni borxhin ndaj DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut duke marrë pjesë në një program të kualifikuar të punësimit të DSS-së, referojuni fletushkës "**Programi i suksesit të prindërve: Pyetjet e shpeshta të punësimit.**"

### **Si ta zbuloj nëse kam borxh të përhershëm të caktuar për mbështetjen financiare për fëmijën?**

Programi i Suksesit të Prindërve mund të reduktojë borxhin e përhershëm që keni ndaj DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut, i cili ndodh kur mbështetja financiare për fëmijët nuk paguhet plotësisht gjatë kohës që fëmija përfiton ndihmë ekonomike. Për të zbuluar nëse keni detyrime ndaj Departamentit të Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut:

- Vizitoni Qendrën Fizike të Shërbimit të Klientit të Zyrës së HRA-së për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS), planifikoni një takim virtual, ose paraqituni pranë një zyre të OCSS-së në Gjykatën për Çështjet Familjare. Kërkoni që çështje juaj të rishikohet nga një punonjës i mbështetjes financiare për fëmijët. Për më shumë informacion, vizitoni <https://on.nyc.gov/contactocss>; ose
- Pyesni ofruesin tuaj të trajtimit të varësisë nga droga nëse ka Child Support Snapshot. Nëse po, ju mund t'i jepni leje për të kontrolluar çështjen tuaj të mbështetjes financiare për fëmijët. Ai mund t'ju tregojë nëse keni detyrime ndaj DSS-së dhe shumën përkatëse. Borxhi ndaj DSS-së në një rreth ose shtet tjetër nuk përfshihet në këtë program.

### **Çfarë duhet të bëj?**

Ndiqui këto tre (3) hapa të thjeshtë:

1. Përfundoni programin tuaj të trajtimit të varësisë nga droga. Programi juaj duhet të jetë i certifikuar nga Zyra e Shërbimeve kundër Alkoolizmit dhe Abuzimit me Substancat e shtetit të Nju-Jorkut (New York State Office of Alcoholism and Substance Abuse Services, OASAS). Ju mund të kualifikoheni nëse jeni në një program trajtimi ambulator ose rezidencial. Programi ambulator duhet të jetë i miratuar nga Administrata e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration, HRA) e qytetit të Nju-Jorkut. Ju duhet të plotësoni të gjitha kërkesat e programit për 90 ditë. Programet e reduktimit të dëmit dhe programet e trajtimit me metadon nuk kualifikohen.
2. Merrni një certifikatë ose letër nga ofruesi juaj i trajtimit të varësisë nga droga ku shkruhet se e keni përfunduar programin, krahas datës së përfundimit të programit. Gjithashtu do t'ju kërkohet që të nënshkruani një formular me anë të së cilit i jepni OCSS-së leje për të telefonuar ofruesin tuaj të trajtimit të varësisë nga droga nëse kemi nevojë për më shumë informacion.
3. Dërgoni dokumentet tuaja pranë OCSS-së me postë, email ose fizikisht.

### **Si mund ta dërgoj vërtetimin që kam përfunduar trajtimin e varësisë nga droga?**

Ju mund të dërgoni dokumente në 3 mënyra: me postë, email ose fizikisht. Nëse dërgoni një letër me postë ose email, sigurohuni që të shkruani se dëshironi të regjistrohemi në Programin e Suksesit të Prindërve. Është e rëndësishme që të përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën, si dhe datën e lindjes.

**ME POSTË:** **Parent Success Program**  
NYC Office of Child Support Services  
P.O. Box 830, Canal Street Station  
New York, NY 10013

**FIZIKISHT:** **QENDRA FIZIKE E OCSS-SË PËR SHËRBIMIN E KLIËNTIT**  
151 West Broadway, 4<sup>th</sup> Floor  
New York, NY 10013  
**GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE NË BRONX**  
900 Sheridan Avenue, LM Floor  
Bronx, NY 10451  
**GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE NË BROOKLYN**  
330 Jay Street, 12<sup>th</sup> Floor  
Brooklyn, NY 11201

**ME EMAIL:**  
[ParentSuccess@dfa.state.ny.us](mailto:ParentSuccess@dfa.state.ny.us)

**GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE NË MANHATTAN**  
60 Lafayette Street, 1<sup>st</sup> Floor  
New York, NY 10013  
**GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE NË QUEENS**  
151-20 Jamaica Avenue, 4<sup>th</sup> Floor  
Jamaica, NY 11432  
**GJYKATA E ÇËSHTJEVE FAMILJARE NË STATEN ISLAND**  
18 Richmond Terrace  
Staten Island, NY 10301

**Sa kohë pasi të përfundoj trajtimin e varësisë nga droga duhet të paraqes dëshminë time?**

Ju mund ta dërgoni dëshminë tuaj në çdo kohë pasi të përfundoni trajtimin. Data në të cilën përfundoni trajtimin duhet të jetë më ose pas datës 1 dhjetor 2024.

**Pasi t'ju paraqes dëshminë time, pas sa kohësh do të reduktohet borxhi i mbështetjes financiare për fëmijët?**

Deri në tetë (8) javë. Kur OCSS merr dokumentet tuaja, ne do të kontrollojmë nëse keni detyrime ndaj DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut. Ne mund të telefonojmë ofruesin tuaj të trajtimit të varësisë nga droga për të verifikuar nëse e keni përfunduar programin e trajtimit. Pasi të bindemi se kualifikoheni, do t'ju dërgojmë me postë një njoftim me shumën që është reduktuar borxhi ndaj DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut. Nëse nuk kualifikoheni, do t'ju njoftojmë me anë të një letre.

**A mund të ndërmerren veprime ekzekutuese ndaj meje për mospagimin e mbështetjes financiare për fëmijët gjatë trajtimit të varësisë nga droga?**

Po. Të gjitha veprimet ekzekutuese të zbatueshme do të vijnë.

**Si mund të kualifikohem për reduktimin e plotë prej \$7,500? A duhet të kem një detyrim prej \$7,500 ose më shumë për ta përfituar atë?**

Nëse i detyroheni \$7,500 ose më shumë DSS-së, ju mund të kualifikoheni për reduktimin prej \$7,500. Ju mund të dërgoni një certifikatë ose letër nga ofruesi juaj i trajtimit të varësisë nga droga ku shkruhet se e keni përfunduar trajtimin. Jo, ju nuk duhet të keni një detyrim prej të paktën \$7,500. OCSS do të reduktojë çdo shumë deri në \$7,500.

**A mund të regjistrohem në Programin e Suksesit të Prindërve më shumë se një herë?**

Po, ju mund të regjistroheni më shumë se një herë. Nëse përfundoni një program të dytë të trajtimit të varësisë nga droga dhe keni ende detyrime ndaj DSS-së, ju mund të kualifikoheni për një reduktim tjetër. Megjithatë, shuma totale maksimale e borxhit që mund të reduktohet për përfundimin e trajtimit të varësisë nga droga është \$7,500.

**Nëse paguaj mbështetje financiare për fëmijën, mund të marr vizita?**

Në qytetin e Nju-Jorkut, vendimet për urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën dhe të drejtat e takimit merren nga dy gjykata të ndryshme. Nëse keni nevojë për informacion ose ndihmë me të drejtën për të vizituar fëmijën tuaj, telefononi Family Legal Care në numrin (212) 343-1122 ose vizitoni [familylegalcare.org/helpline](http://familylegalcare.org/helpline).

**Kam pyetje të tjera. Çfarë duhet të bëj?**

Pyesni stafin e programit tuaj të punësimit të DSS-së ose stafin e programit të trajtimit të varësisë nga droga rreth "Programit të Suksesit të Prindërve" të OCSS-së ose kontaktoni OCSS-në me email, fizikisht ose me postë. Për më shumë informacion, vizitoni <https://on.nyc.gov/contactocss>.

**A keni ndonjë problem shëndetësor ose problem të shëndetit mendor apo aftësi të kufizuara? A e keni të vështirë që për shkak të këtij problemi të kuptoni atë çfarë thuhet në njoftim apo të bëni atë që ju kërkohet? A ju vështirëson kjo gjendje përfitimin e shërbimeve të tjera në HRA? **Ne mund t'ju ndihmojmë.** Na telefononi në numrin **718-557-1399**. Gjithashtu, ju mund të kërkonit ndihmë duke u paraqitur pranë një zyre të HRA-së. Ju gëzoni të drejtën ta kërkonit këtë lloj ndihme në përputhje me ligjin.**